

Procesverbal

Nga Mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 11.12.2025

Usmen Baldzi: Përshëndetje të gjithëve. Dua t'ju informoj të pranishmit se do të vazhdoj fjalën dhe udhëheqjen e mbledhjes në gjuhën shqipe, me qëllim që institucionet e pranishme, lokale apo qendrore, të kuptohemi më mirë, ashtu si edhe me komunitetin shumicë që është në Dragash, duke pasur parasysh se mund të ketë barriera gjuhësore, në mënyrë që të kuptohemi sa më qartë. Në emrin tim personal i përshëndes të gjithë të pranishmit këtu, dhe pasi jam i vetmi këtu nga përfaqësuesit tanë në pushtet në Dragash, nga ana e kuvendit të parë të lirë në komunën e Dragashit pas luftës, si i vetmi anëtar, dua të shpreh kënaqësinë që pas 25 vitesh po bëhem sërish anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Resul Fetahu: Përshëndetje për të gjithë! Nga radhët e LDK-së propozoj Arijeta Qafleshi Skeraj!

Sherafidin Osmani: Nga radhët e PDK-së propozojmë Granit Rifaj!

Ventaza Esati: Nga radhët e JGP propozojmë Danis Hodza!

Arijeta Skeraj: Faleminderit të gjithëve që na keni nderuar dhe keni ardhë të merrni pjesë në ceremoninë e betimit e kryetarit dhe anëtarëve të Kuvendit! Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve, duke u bazuar në listën e certifikimit nga KQZ, si dhe në listën e nënshkrimeve të asambleistëve, konstatohet se të gjithë mandatet janë verifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. U uroj suksese të gjithë asambleistëve dhe punë të mbarë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre! Faleminderit!

Usmen Baldzi: Pasi që Komisioni i verifikoi mandatet, ju ftoj delegatë që të ngriheni në këmbë për të dhënë betimin, si shprehje e përkushtimit për ushtrimin e detyrës me ndershmëri, përgjegjësi dhe besnikëri ndaj ligjit dhe qytetarëve. Unë do të lexoj betimin dhe ju do të përsërisni pas meje, duke përmendur secili emrin e vet. Betimi do të lexohet fillimisht në gjuhën shqipe dhe pastaj në gjuhën e komunitetit. Pasi të lexojmë betimin, ju lus që të gjithë ta nënshkruani atë dhe ta dërgoni në Zyrën e Kuvendit:

Unë, betohem ose deklaroj solemnisht, se do të kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje, dhe sipas ligjit, detyrat, dhe do të ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë! Betohem!

Urime dhe na priftë e mbara! Në emër të institucioneve komunale, ju uroj punë të mbarë, vendimmarrje të mençur dhe suksese në përmbushjen e detyrave që na presin gjatë këtij mandati. E ftoj kryetarin e Komunës që ta japë betimin.

Bexhet Xheladini: *Unë, Bexhet Xheladini, betohem ose deklaroj solemnisht, se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si kryetar i Komunës së Dragashit, me nder e besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë! Betohem!*

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj nga zemra të gjithë juve, qytetarëve, për besimin që ma keni dhënë edhe një herë për ta udhëhequr Komunën tonë. Ky besim për mua është nder i madh, po r edhe përgjegjësi e jashtëzakonshme. Ju siguroj se ky mandat do të jetë vazhdim i punës së palodhshme, me përkushtim, transparencë dhe rezultate konkrete – ashtu siç kemi dëshmuar në mandatin e parë.

Të nderuar anëtarë të rinj të Kuvendit të Komunës së Dragashit,

Ju uroj mirëseardhje dhe suksese në detyrën tuaj. Sot, secili prej nesh e ka dhënë betimin para qytetarëve, dhe ky betim është zotimi ynë që interesin publik do ta vendosim mbi çdo interes tjetër.

Gjatë katër viteve të kaluara kemi punuar me përkushtim në shumë fusha: në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik dhe administratë më efikase. Kemi realizuar projekte të rëndësishme dhe kemi vendosur themelet e një transformimi që duhet të vazhdojë.

Qytetarët na e kanë besuar edhe një mandat sepse së bashku kemi dëshmuar se qeverisja e mirë është e mundur:

- Katër vite me qeverisje me duar të pastra, pa asnjë rast korrupsioni e pa asnjë aktakuzë ndaj zyrtarëve komunalë;
- Katër raporte radhazi të auditorit me vlerësime të shkëlqyera për transparencën financiare;
- Katër vite radhazi fitues të Grantit të Performancës;
- Mbi 10 milionë euro investime, duke përfunduar infrastrukturën në mbi 90% të vendbanimeve dhe duke sjellë ujësjellësin për 15 fshatra e qytezën e Dragashit;
- Investime të rëndësishme në arsim, shëndetësi, kulturë, rini e sport, transport falas për nxënësit dhe shërbime shëndetësore falas për qytetarët.

Të nderuar qytetarë,

Sot, me marrjen e këtij besimi për herë të dytë, dua të ritheksoj: Unë do të jem kryetar i të gjithëve. Do t'i shërbej secilit qytetar njësoj – pa dallim bindjeje politike, etnie apo vendbanimi. Për mua, çdo njeri i kësaj komune është qytetar i barabartë, jo votues apo përfaqësues partie.

Mandati i dytë që fillojmë sot do të jetë mandat i thellimit të punës, i përfundimit të projekteve të mëdha dhe i hapjes së mundësive të reja për komunitetin tonë.

Për katër vitet e ardhshme, punët tona prioritare do të përfshijnë:

- Përfundimin e infrastrukturës rrugore dhe ndriçimit publik në të gjitha vendbanimet;
- Investime të reja në shëndetësi, arsim, kulturë dhe sport;
- Përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve moderne për fëmijët tanë;
- Zhvillimin e infrastrukturës sportive dhe hapësirave të reja për rininë;
- Finalizimin e PZHK-së dhe hartave zonale për planifikim të qëndrueshëm urban e rural;
- Zgjidhjen e çështjeve të pronave me AKP-në për zhvillim më të fuqishëm ekonomik, blegtorial, bujqësor dhe në energji të ripërtrishme;
- Nxitjen e turizmit, i cili pritet të marrë hov të ri me ndryshimet në ligjin e Parkut Kombëtar.

Të gjitha këto do të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe në zhvillimin e gjithanshëm të Komunës sonë.

Në fund, dua të shpreh mirënjohjen time të veçantë për familjen time për mbështetjen e pandalshme dhe për Zonjën e Parë të Komunës, e cila ka treguar përkushtim dhe vullnet të jashtëzakonshëm në çdo hap të këtij rrugëtimi. Pa mbështetjen e saj, nuk do të isha sot këtu.

Ju falënderoj edhe një herë për besimin! Premtoj se këtë besim tuajin do t'ua kthej me punë të ndershme dhe rezultate konkrete.

Le të jetë ky fillim i një kapitulli të ri suksesi për Komunën e Dragashit. Le të punojmë së bashku me energji të re, me vullnet, me ide të reja, me respekt ndaj njëri-tjetrit dhe me përkushtim të përbashkët për të mirën e qytetarëve tanë.

Zoti e bekoftë Komunën tonë dhe gjithë qytetarët e Dragashit!

Ju faleminderit!

Usmen Baldzi: